



# Shoqata Kosovare e të Shurdhërve

Numri i Regjistrimit si OJQ: 5111040-4  
FAH postal 342, 10000 Prishtinë, Kosovë  
[Deafkosovar@gmail.com](mailto:Deafkosovar@gmail.com)

Prishtinë, 13 Maj 2013

**Për:** E hapur për të gjithë

**Lënda:** Intervista për instruktor të gjuhës së shenjave dhe asistent klase

Më lejoni që në emër të Bordit të SHKSH-së të ju ftojë në intervistën për instruktor të Gjuhës së Shenjave Kosovare dhe asistent në klase.

Shoqata Kosovare e të Shurdhërve me përkrahjen financiare të Shoqatës Finlandeze të Shurdhërve dhe Ministris Arsimit, Shkencës dhe Teknologjis kanë arritur nënshkrimin e marrveshjes mbi projektin e AKIGJSH-së, në bazë të kësaj do të mbahen trajnime për instruktor të Gjuhës së Shenjave dhe asistent klase. Ky trajnim ka për qëllim që të aftësojë personat e Shurdhër në lëmin e Kulturës së Shurdhërve dhe gjuhës së shenjave.

SHKSH dëshiron që të zhvillojë ekspert në lëmin e kulturës së Shurdhërve dhe gjuhës së shenjave në mënyrë që të ngrisë vetëdijen lidhur me kulturën e të Shurdhërve dhe gjuhën e shenjave. Duke ndjekur këtë trajnim ju do të ndihmoni të ardhmen e komunitetit të Shurdhër në Kosovë.

### **Kush mund të marrë pjesë në këtë trajnim?**

Pjesëmarrja në këtë trajnim është e hapur për të gjithë komunitetin e të Shurdhërve në Kosovë.

- Të gjithë personat të cilët janë të Shurdhër dhe të cilët kanë mbushur moshën madhore ( mbi 18 vjec)
- Poashtu SHKSH inkurajon pjesëmarrjen e femrave ne këtë trajnim .
- Të gjithë ata të cilët janë të interesua dhe motivuar

### **Ku dhe Kur?**

Intervista do të mbahet në zyrat e SHKSH-së, Rr. Nazim Gafurri Nr. 28/2-1, Prishtinë  
Me datën 22 Maj 2013, duke filluar nga ora 10:00

Ju lutem informoni shokët/qet tuaj lidhur me intervistën. Jeni të mirëseardhur

Për informacione shtesë ju lutem kontaktoni ne email: [deafkosovar@gmail.com](mailto:deafkosovar@gmail.com) ose në nr.tel 044 655 503 (vetëm sms).

Enver Kurtalani  
Drejtor i SHKSH-së